

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Prill 2025

Nr.	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundi mit të kërkesës	Tarifa
1.	09.04.2025	Kërkesë për informacion lidhur me statusin e një prone (vendstrehim), mbi të cilin pretendohet se do të ndërtohet një pallat shumëkatësh në Tiranë.	15.04.2025	Bazuar në VKM nr. 500, datë 14.8.2001, i ndryshuar dhe udhëzimit nr. 3, date 18.7.2002 të Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike "Për inventarizimin e pronave shtetërore nga Njësitet e Qeverisjes Vendore", objektet vendstrehim janë ne inventar te Pushtetit Vendor (bashkive) . Nga verifikimi i listës së pronave në inventar të Ministrisë së Mbrojtjes rezulton se në zonën për të cilën ka interes, institucioni i mbrojtjes nuk ka prona në administrim të saj. Bazuar në piken 9, të VKM nr. 280 datë 15.1.1996, i ndryshuar, heqja apo prishja e objekteve fortifikuese mbrojtëse bëhet vetëm me miratim të ministrit të Mbrojtjes, kur kërkesa për këtë qellim duhet të vijë nga bashkia që ka në administrim objektin vendstrehim.	E plotë	0
2.	11.04.2024	Kërkesë për informacion lidhur me rastet e përdorimit operacional të shërbimit satelitor nga Albania 1 dhe Albania 2 në menaxhimin e emergjencave civile, etj.,	21.04.2025	 kthim pergjigje.docx		0

3.	14.04.2025	Kërkesë për informacion lidhur me procedurën blerje ndërtese dhe trualli pranë një ish repartit ushtarak si dhe vënien në dispozicion të dokumentacionit përkatës për të vijuar me procedurat e mëtejshme ligjore.	24.04.2025	Kërkesa për privatizim të pasurive shtetërore duhet t'i drejtohet Ministrisë së Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit, (MEKI) pasi procesi i privatizimit të pasurive të paluajtshme shtetërore drejtohet nga kjo ministri sipas kërkesave të përcaktuara në Vendimin nr.926, datë 29.12.2014 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet, dhe procedurën e shitjes" të ndryshuar.		0
4.	28.04.2025	Kërkesë për informacion mbi vendimin e “papërshtatshmërisë” në procesin e rekrutimit në FA.	29.04.2025	Bazuar në udhëzimin e Ministrit të Mbrojtjes nr. 2021, datë 15.08.2024, “Për procedurat dhe kriteret e rekrutimit të ushtarëve/detarëve aktiv në Forcat e Armatosura”, parashikohet që kandidatët ushtar/detar aktiv në Forcat e Armatosura, duhet të plotësojnë kushtin e sigurisë, si një nga kriteret për t’u bërë pjesë e FA.		0